

Akt Themelimi
i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar "TRIO GELATO"

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për shoqëritë tregtare" dhe në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Q.K.R" dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, sot më datë 25/04/2022 me ortakët:

1. **Harrilla BIFSHA** i pajisur me ID Nr I50308115A
2. **Arjan MIHAJ** i pajisur me ID Nr J10917021G
3. **Liridjon NAZARKO** i pajisur me ID Nr I70413075U

krijojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "TRIO GELATO" me akt themelimi si vijon:

Neni 1

Formimi i shoqërisë

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur "TRIO GELATO". Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Neni 2

Selia e shoqërisë

- Selia e shoqërisë "TRIO GELATO" do të jetë: Dhermi, Zona kadastale 1481, Rruga "Shetitorja e Dhermiut", Ndertesa Nr 8.
- Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:
triogelaterie@gmail.com

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 3

Objektivi i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë veprimtaritë si vijojnë:

- Bar-Restorant-Gelateri

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë


Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat 20 (njetzet) vjetar. Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë private "TRIO GELATO" do të jetë 100 (njqind) Lek dhe është i ndarë në aksione në përputhje me ligjin.

1. Ortaku themelues **Harrilla BIFSHA**: Zotërues i një kuote te vetme që përbën 34% te kapitalit themeltar të shoqërisë.



2. Ortaku themelues **Arjan MIHAJ**: Zotërues i një kuote te vetme që përbën 33% te kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Ortaku themelues **Liridjon NAZARKO**: Zotërues i një kuote te vetme që përbën 33% te kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6

Drejtimi i shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga administratori z. **Harrilla BIFSHA**. Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj .
Cdo kontrate do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posacme .

Neni 7

Ortakët themelues kanë të drejte të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale, kanë të drejtë të caktojnë financiere dhe likuidatorë për problemet e shoqërisë.

Neni 8

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë .

Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme , me tekstin rreth saj .

Neni 10

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërive Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

Neni 11

Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje , për t'ju shperndare organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "**TRIO GELATO**".

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakut i vetëm .

Ortakut i "**TRIO GELATO**"

Harrilla BIFSHA



Ortakut i "**TRIO GELATO**"

Arjan MIHAJ



Ortakut i "**TRIO GELATO**"

Liridjon NAZARKO

